



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEQA"

MENAXHIMI I RISKUT

HYRJE NË MENAXHIMIN E RISKUT

Ph.D. Fisnik Morina



SHKURT , 2018

MENAXHIMI I RISKUT

- Lënda: Menaxhimi i Riskut
- Viti III-të, Semestri VI, Departamenti: KF
- Statusi i lëndes: Obligative
- Javët mësimore: 15 (2 orë ligjerata, 2 orë ushtrime)
- Mësimdhënes: Prof. Asoc. Dr. Ibish Mazreku
Ph.D. Fisnik Morina
- Emaili: ibish.mazreku@unhz.eu
fisnik.morina@unhz.eu

Qëllimet e lëndës:

- Ky kurs i dedikohet gjithë atyre që dëshirojnë një hyrje të plotë në teorinë dhe zbatimin e menaxhimit të rrezikut. Në këtë lëndë përcaktohet një hyrje e integruar në menaxhimin e rrezikut në organizatat publike dhe private.
- Studimi i këtij moduli siguron informacione në botën e menaxhimit të rrezikut dhe mund të ndihmojë studentet të vendosin nëse menaxhimi i rrezikut është një opsion i përshtatshëm i karrierës së tyre.
- Hyrja në menaxhimin e rrezikut është dhënë në pjesën e parë të këtij moduli si dhe karakteristikat kryesore të menaxhimit të rrezikut janë të përcaktuara në dy pjesët e ardhshme.

Përshkrimi i lëndës

- Menaxhimi i riskut ofron një qasje të integruar për vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e rreziqeve të organizatës.
- Ky kurs shqyrton se si mund të aplikohen komponentët kyçe të menaxhimit të rrezikut.
- Gjithashtu edhe shembujt e dhënë janë kusht që të demonstrojnë përfitimet e menaxhimit të rrezikut të organizatave në të dy sektorët, në atë publikë dhe privatë.

Rezultatet e pritura të nxënies:

- Programi ka për qëllim të ofrojë njohuri të avancuara, të njohë dhe aftësojë studentët për përdorimin specifik të koncepteve, teorive dhe metodave nga menaxhimi i riskut dhe që ata t'i aftësojë të shpjegojnë dhe interpretojnë probleme të veçanta, të bëjnë ndërlidhjen e këtyre problemeve me fushat e tjera ekonomike, të formulojnë opinione të qëndrueshme nga fusha e menaxhimit të riskut.

Metodologjia e mësimëdhënies:

- Prezantimi i temës mësimore në Power Point
- Përsëritja e temës paraprake nga grupi i caktuar i studentëve, analiza dhe diskutime
- Rast studimi apo detyrë (për orën e ushtrimeve) lidhur me temën e ligjëruar

Metodat e vlerësimit:

- Prezantimi dhe puna grupore: 0 - 10%
- Punimi seminarik: 0-10%
- Testi I 0-40%
- Testi II 0-40%
- Provimi përfundimtar 0- 80%

Literatura bazë dhe literatura shtesë:

- **Paul Hopkin - Fundamentals of Risk Management: Understanding, Evaluating and Implementing Effective Risk Management, 4th edition.**

Literatura shtesë:

- Michel Crouhy & Dan Galai & Robert Mark (2006) - The Essentials of Risk Management
- John C. Hull – Risk Management and Financial Institutions (Wiley Finance) 4th Edition

Plani i dizajnuar i mësimit

Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Qasjet në përkufizimin e rrezikut
Java e dytë:	Ndikimi i riskut në organizatat e biznesit
Java e tretë:	Llojet e rreziqeve
Java e katërt:	Zhvillimi i menaxhimit të rrezikut
Java e pestë:	Parimet dhe qëllimet e menaxhimit të rrezikut
Java e gjashtë:	Standartet e menaxhimit të rrezikut
Java e shtatë:	Struktura e menaxhimit të rrezikut
Java e tetë:	Testi i parë vlerësues

Plani i dizajnuar i mësimit

Java e nëntë:	Dokumentacioni i menaxhimit të rrezikut
Java e dhjetë	Përgjegjësi e menaxhimit të rrezikut
Java e njëmbëdhjetë:	Kultura e menaxhimit të rrezikut
Java e dymbëdhjetë :	Trajnimi dhe komunikimi i riskut
Java e trembëdhjetë:	Kompetencat e praktikuesve të rrezikut
Java e katërbëdhjetë:	Vlerësimi i rrezikut
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi i dytë vlerësues

Hyrje

- **Menaxhimi i riskut** është disipline e re, e cila karakterizohet me një zhvillim të shpejte dhe pikëpamje të shumta, përshkrime të larmishme: se çfarë involvon ne vete, dhe si duhet të administrohet .
- Standardet në fjalë duhet siguruar se ekziston një përputhshmëri sa i përket:
 - terminologjisë lidhur me shprehjet (fjalët) e shfrytëzuara,
 - procesit sipas të cilit menaxhimi i riskut mund të performohet
 - strukturës organizative për menaxhimin e riskut, si dhe
 - qëllimit të menaxhimit të riskut.

Hyrje

- Fatmirësisht, standardet vejnë në pah atë se risku posedon si aspektin negativ (dobësues) ashtu edhe atë pozitiv (përfitues).
- Menaxhimi i riskut nuk ka te beje vetëm me korporatat apo organizatat publike, por për çdo aktivitet qoftë afatgjate apo afatshkurtër.
- Përfitimet dhe mundësit duhet shikuar jo vetëm ne aspekt te vete aktivitetit por edhe ne relacion me pjesëmarrësit e ndryshëm qe munde te involvohen.

Risku

- **Risku** mund të definohet si kombinim i probabilitetit të një ngjarjeje dhe pasojave të saj.
- Ne çdo ndërmarrje, ekziston mundësia e ndodhjes së ngjarjeve dhe pasojave të tyre të cilat karakterizohen me mundësi ngritjeje (përfituese) apo rënëse (kërcënuese).
- Gjithnjë e më shumë është bërë e ditur se menaxhimi i riskut ka të bëjë si me aspektin pozitiv të riskut ashtu edhe me atë negativ.
- Prandaj ky standard e merr në konsideratë riskun nga të dy perspektivat.

Menaxhimi i riskut

- Menaxhimi i riskut është pjese qendrore (thelbësore) e menaxhimit strategjik të një organizate.
- Është proces me ane te se cilit organizatat ne mënyre metodologjike e adresojnë riskun si pjese përcjellëse te aktivitetit te tyre, me qellim te arritjes se përfitimeve te pandërprera ne secilin aktivitet si dhe ne te gjithë portfolion e aktiviteteve.
- Fokus i menaxhimit te mire te riskut është identifikimi dhe trajtimi i këtyre risqeve.
- Qëllimi e tij është te shtoj ne maksimum vlerën mbështetëse të të gjitha aktiviteteve te organizatës.

Menaxhimi i riskut

- Thekson (vë në pah) faktorët potencial nxitës si dhe ata rrënues të cilët mund të kenë ndikim në organizatë.
- Rrite probabilitetin për sukses, si dhe zvogëlon atë për dështim apo pasiguri në arritjen e objektivave të përgjithshme të organizatës.
- Menaxhimi i riskut duhet të jetë një proces i vazhdueshëm dhe zhvillimor, i cili realizohet përmes strategjisë së organizatës si dhe implementimit të asaj strategjie.
- Duhet të adresoni në mënyrë metodologjike të gjitha risqet e përafërta që kanë përcjellur organizatën në të kaluarën, në të tani, dhe në veçanti në të ardhmen.

Definimi i menaxhimit të riskut

- Menaxhimi i riskut vepron në parandalimin e kërcënimeve që i kanosen një organizatë apo personi, që pasojat e kërcënimeve të kontrollohen dhe zvogëlon gjasat që kërcënimet të shkaktojnë pasoja (dëme), përndryshe ato do të shkaktojnë dëme, “ Risku ” definohet si “kombinim i probabilitetit të një ngjarje dhe pasojat e saj”
- Nevoja e veçantë për qartësim del pjesërisht nga shkaku se risku është pjese integrale e të gjitha aspekteve të jetës së përditshme.
- Si rrjedhojë secili e ka pikëpamjen e vet se çka është risku, se çka është menaxhimi i riskut.

Menaxhimi i riskut si një proces



“ Procesi i menaxhimit të riskut është procesi nëpërmjet të cilit shoqëritë tregtare përpiqen të sigurohen që risqet ndaj të cilave ato janë të ekspozuar janë risqet ndaj të cilave ato mendojnë se janë dhe duhet të jenë në mënyrë që të maksimizojnë vlerën e shoqërisë tregtare”.

Ky proces organizativ mund të ndahet në pesë nënprocese:



- Vendorsja e objektivave,
- Identifikimi i riskut,
- Vlerësimi i riskut,
- Trajtimi i riskut dhe
- Mbikëqyrja e menaxhimit të riskut

Vendosja e objektivave, oreksi për riskun dhe toleranca ndaj riskut.



Vendosja e objektivave është kusht paraprak për:

- identifikimin,
- vlerësimin dhe
- trajtimin e risqeve

Për vetë faktin e thjeshtë se risqet nuk janë gjë tjetër veçse ngjarje që kanë ndikim negativ apo pozitiv në arritjen e objektivave.

Objektivat e çdo shoqërie tregtare ndahen në dy lloj objektivash



a) objektiva strategjike dhe

b) objektiva të lidhura me objektivat strategjike.

Objektivat strategjike janë objektiva të përgjithshme në zbatim të strategjisë së saj në përputhje me vizionin.

Objektivat e lidhura me objektivat strategjike janë objektiva në shërbim të objektivave strategjike ose objektiva në lidhje me rrugën apo rrugët e përcaktuara për arritjen e objektivave strategjike.

Oreksi për risk



Oreksi për risk është shuma e riskut që një ndërmarrje dëshiron të pranojë në kërkim (në ndjekje) të vlerës.

Ai mund të shprehet në terma sasiorë si për shembull

- vlera në risk,
- të ardhurat në risk,
- rrjedha monetare në risk etj.

Por mund të shprehet edhe me terma cilësorë.

1. Identifikimi i riskut (ngjarjes)



Identifikimi i riskut është procesi nëpërmjet të cilit një ndermarrje identifikon ngjarje të mundshme të cilat, po ndodhën, do të ndikojnë tek arritja e objektivave.

Po kështu nëpërmjet këtij procesi, përcaktohet nëse ndikimi i këtyre ngjarjeve të mundshme tek objektivat e ndermarrjeve është ndikim negativ apo ndikim pozitiv.

2. Vlerësimi i riskut



- Vlerësimi i riskut bëhet si për **riskun natyral (i qënësishëm)** ashtu edhe për **riskun e mbetur**.
- **Risku natyral** është risku në mungesë të veprimeve që drejtuesit ndërmarrin për të ndryshuar gjasën e riskut, ndikimin e riskut ose të dyja së bashku.
- **Risku i mbetur** është risku që ka mbetur pas veprimeve të ndërmarra nga drejtuesit në përgjigje ndaj riskut natyral.



3. Trajtimi i riskut

Trajtimi i riskut është procesi i përzgjedhjes dhe zbatimit e masave për të modifikuar riskun.

Trajtimi i riskut përfshin si elementin e tij kryesor,

- përgjgjen ndaj riskut,
- veprimtarinë e kontrollit të riskut si dhe
- informimin dhe komunikimin për riskun.

Përgjigja ndaj riskut



a) **Shmangia e riskut**

Në këtë rast risku i mbetur perceptohet i barabartë me zero.

b) **Pranimi i riskut**

Risku i mbetur do të jetë i barabartë me riskun e qënësishëm.

c) **Zbutja e riskut**

risku i qënësishëm zbutet duke zbritur në nivelin e riskut të mbetur i cili nga ana e vetë nuk është i barabartë me zero, por gjithnjë perceptohet më i madh se zero.



4. Kontrolli i Riskut

- ❖ Aktivitetet e kontrollit janë politika dhe procedura që ndihmojnë të sigurojnë që reagimet manaxheriale ndaj riskut janë zbatuar.
- ❖ Aktivitetet e kontrollit bëhen në të gjithë organizatën, në të gjitha nivelet dhe në të gjitha funksionet.
- ❖ Ato përfshijnë një varg aktivitetimesh – si shumëllojshmëria e aprovimeve, autorizimet, verifikimet, bashkërendimet, rishikimet e performancës operationale, sigurimi i kapitaleve dhe ndarjen e detyrave.

5. Monitorimi i drejtimit të riskut



Kështu, hapi përfundimtar i procesit të drejtimit të riskut është monitorimi i vetë procesit të drejtimit të riskut.

Monitorimi përfshin:

- rishikimin (revizionimin) e riskut,
- mbikëqyrjen e procesit si edhe
- rishikimet e brendshme të metodave të matjes së riskut.

Menaxhimi i riskut është një proces që mund edhe të “dështojë”.



- E para, menaxhimi i riskut mund të dështojë në dhënien e informacionit të duhur tek punonjësit e duhur.
- E dyta, procesi i menaxhimit të riskut mund të “dështojë” nëse ndërmarrja nuk lidh vlerën e shtuar nga menaxhimi i riskut me shpenzimet për të siguruar këtë vlerë të shtuar.
- E treta, menaxhimi i riskut mund të dështojë po të përqëndohet vetëm tek kontrolli i riskut dhe pa e lidhur me përfitimet që vijnë nga marrja përsipër e riskut.

Ju Faleminderit për vëmendje !

□ SUKSESE !

